**VENDIM**
**Nr.354, datë 29.4.2020**

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS ME PERSONEL INFERMIER PËR REPUBLIKËN E ITALISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 35, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës me 60 vetë, personel infermier, në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, Republikës së Italisë.
2. Shpërblimi i infermierëve, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, është 2 500 (dy mijë e peseqind) euro në muaj.
3. Fondi prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e personelit infermier, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që të bëjë përzgjedhjen e infermierëve të cilët do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë.
5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të sigurojnë transportin e personelit infermier drejt Italisë.
6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**